

VENDIM
Nr. 38, datë 10.2.2025

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË “GEGA-G” SHPK PËR RINOVIMIN E
LICENCËS NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 67, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.2.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 189/3 prot., datë 5.2.2025, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Gega-G’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, dhe u njoh me qëndrimin e Sekretarit të Përgjithshëm dhe Këshilltares së ERE-s,

konstatoi se:

- Shoqëria “Gega-G” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike për një afat 5-vjeçar, me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 64, datë 8.4.2020.

- Ajo ka paraqitur kërkesën për rinovimin e kësaj licence, brenda afateve të përcaktuara në nenin 16, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar.

- Nga shqyrtimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit, ka shlyer të gjitha pagesat e rregullimit dhe ka depozituar dokumentacion referuar kërkesave të nenit 16 të kësaj rregulloreje.

- Në nenin 67, të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, (ligji nr. 44/2015) përcaktohet se gjatë një procedure administrative, autoriteti publik mund të nxjerrë vendime të ndërmjetme që nuk përfundojnë çështjen, por që janë të nevojshme për vazhdimin e saj.

- Për të siguruar kohën e nevojshme për sqarimin e dokumentacionit të dorëzuar nga shoqëria në lidhje me këtë aplikim, pasi nuk janë dhënë shpjegime për ndryshimet apo modifikimet e mundshme në dosjen e licencimit, si dhe për zhvillimin e korrespondencave të mundshme, vlerësohet e arsyeshme shtyrja me 30 ditë e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Gega-G” sh.p.k. për licencimin në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike. Brenda 10 ditëve shoqëria duhet të depozitojë në ERE shpjegime për ndryshimet apo modifikimet e mundshme në dosjen e licencimit, sikurse kërkuar në rregullat për rinovimin e licencave nga ERE (rregullore e sipërcituar). ERE ka njoftuar shoqërinë me shkresën nr. 189/2 prot., datë 22.1.2025, për vendimin nr. 23, datë 20.1.2025, “Për fillimin e procedurës për rinovimin e licencës së shoqërisë ‘Gega-G’ sh.p.k., në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike”, dhënë me vendimin e Bordit nr. 64, datë 8.4.2020, shkresë ku ERE i ka kërkuar edhe plotësimin e informacionit të konstatuar të munguar në kuadër të këtij aplikimi.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të shtyjë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes së Bordit të ERE-s për aplikimin e shoqërisë “Gega-G” sh.p.k., për rinovimin e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.

2. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga marrja e këtij vendimi, shoqëria të depozitojë në ERE shpjegime për ndryshimet apo modifikimet e mundshme në dosjen e licencimit.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve të njoftojë shoqërinë “Gega-G” sh.p.k. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti